

Shqetësimet që përkojnë, Stavileci dhe Kadare, një analizë krahasuese

Venera Llunji*

Përmbledhje

Apologji e çështjes shqiptare e Masar Stavileci¹ dhe *Mosmarrëveshja e Kadaresë*² janë dy vepra të shkruara në kohë, në rrethana dhe në hapësira të ndryshme, por të cilat përkojnë me njëra-tjetrën për shqetësimet e mprehta që ngrenë për popullin shqiptar. Përderisa i pari (Stavileci) ngre shqetësimin për gërryerjet nga jashtë dhe nga brenda si pasojë e moskoordinimit të brendshëm për interesa madhore, i dyti (Kadare) ngre shqetësimin për “gërryerjet” nga brenda nga vetë shqiptarët. Stavileci duke shkruar në kohën e para luftës në Kosovë (1999), ngre shqetësimin për dëmtimin zhvillimor kombëtar, shpirtëror, moral e psikik të trupit gjithëshqiptar si pasojë jo vetëm e vërsuljeve të huaja shoviniste, por edhe e oligarkisë dhe paaftësisë së klasës politike e intelektuale të shqiptarëve që, në gjendjet dramatike të popullit tonë, të tejkalojnë vetveten duke lënë prapa interesat e ngushta meskine politike dhe të afrojnë trungun e ndarë shqiptar. Ndërsa, Kadare (2010) ngre shqetësimin për pasojat se si disa individë gërryejnë vlerat identitare dhe shpirtin shqiptar. Ndonëse të shkruara në kohë e rrethana të ndryshme gjeopolitike, të dyja veprat përkojnë në shqetësimin që ngrenë: ruajtjen dhe forcimin e integritetit fizik dhe shpirtëror shqiptar.

Fjalë kyç: Shqiptarë, nacionalizëm, integrim, bashkërenditje, Stavileci, Kadare.

* MEd. Venera Llunji PhD Cand., ligjëruese në Universitetin AAB, Prishtinë.
venerallunji@hotmail.com

¹ Masar Stavileci, *Apologji e çështjes shqiptare*, Forumi i Intelektualëve Shqiptarë, Prishtinë, 1998 (Reprografuar më 2009).

² Ismail Kadare, *Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, sprovë letrare*, Onufri, Tiranë, 2010.

Shqiptarët në udhëkryqin ballkanik

Të ndodhur në një udhëkryq të rëndësishëm gjeopolitik e gjeokulturor ku historikisht janë përplasur edhe perandori, shqiptarët u kanë rezistuar pushtimeve të huaja ndonëse jo pa pasoja. Pasoja më e madhe, e cila gradualisht po pranohet nga historiografia, është se në dallim prej fqinjëve përreth, shqiptarët janë ndodhur të vetmuar, si një “djalë i vetëm” ku përplasia ndodh për interesa të mëdha me familje me “shumë vëllezër”. Të qenit të vetmuar në Ballkan, “pa krah”, ka bërë që pasojat e pushtimit të shqiptarët të jenë më të shprehura, përfshirë edhe ndarjen e kombit në tri konfesionet fetare. Por, rezistenca dhe më vonë largpamësia e rilindësve, ka bërë që shqiptarët ta ruajnë identitetin e tyre etno-kulturor, të kultivojnë dhe të zhvillojnë, madje, më pas, të krijojnë edhe komb-shtetin e tyre, por të mbeten si komb në dy apo më shumë njësi shtetërore.

Lëvizjet politike, sociale dhe kulturore të rrënjosura në konceptet e etnicitetit apo ekzistencës kombëtare, e kanë formësuar botën tonë bashkëkohore. Lojaliteti dhe krenaria e një kombi duke mbjellur besimin se vendi (shteti) i tyre është i rëndësishëm dhe se identiteti i tyre edhe individual është i lidhur ngushtë me vendin e tyre, i bën të gatshëm të bëjnë çmos për të, duke besuar se kombi i tyre është më i rëndësishëm dhe më rezistues se fuqitë e cilitdo pushtues. Pra, kemi të bëjmë me nacionalizmin për të cilin është shkruar shumë. Madje, janë dhënë edhe përkufizime dhe mendime nga më të ndryshmet, si përkrahje për kombin nga pjesëtarët e atij kombi apo edhe si “*ideologji, sentiment, lëvizje*”³.

Megjithatë, zhvillimi i shpejtë ekonomik ndërkombëtar, zhvillimi i teknologjisë së lartë dhe i mediave mund të jenë ndoshta vetëm përpjekje për ta kapërcyer nacionalizmin klasik dhe radikal, sepse edhe Smith argumenton që globalizimi nuk mund t’i bëjë kombet ta humbasin ndjenjën nacionaliste, meqë njerëzit, sipas Smith-it,

³ John Hutchinson & Anthony Smith, *Nationalism: The Reader*, Oxford: Oxford University Press, 1994, f.45

kërkojnë “qëndrueshmëri dhe kuptim në erën e ndryshimeve të papara dhe kthehen te trashëgimitë e tyre etnike”⁴.

Disa studiues, duke bërë përpjekje të mos e gjykojnë idenë e nacionalizmit, e konsiderojnë atë si e drejtë e kombeve për vetëvendosje. Robert Wiebe në veprën e tij *“Who We Are”* e analizon zhvillimin e nacionalizmit dhe paraqet lidhjen e nacionalizmit me forcat e tjera të cilat e kanë formësuar botën moderne, duke e përkufizuar nacionalizmin si “dëshirë të popullit që kanë të përbashkët një trashëgimi dhe fatin të jetojnë nën qeverisjen e tyre, në tokën e shenjtë të historisë së tyre”⁵.

Sot, identiteti kombëtar mbështetet në ndjenjën e përkatësisë së një kombi specifik, i pajisur me: simbolet e veta, traditën, vendet sakrale, ceremonitë, heronjtë, historinë, kulturën dhe territorin. Megjithatë, duket se globalizimi po përpiket ta ndryshojë këtë kontekst. Shumë shtete po përjetojnë sfidën e tyre të madhe në krijimin e shoqërive të ashtuquajtura me “identitet pluralist” përballë “identitetit kombëtar”. Frika e tyre se ndoshta një përpjekje e tillë do të dështojë, është me bazë. Prandaj, nacionalizmi si politikë shtetërore ose si ideologji kombëtare lë hapësirë për mospajtime dhe për kundërshtime.

Edhe sot, nacionalizmi dhe etniciteti janë pjesë e tërësisë së një identiteti të caktuar dhe të mbrojtur si në luftërat politike, ashtu edhe në ato sociale. Shqiptarët, mjerisht, gjatë historisë së tyre, gjithmonë janë përballur me nacionalizëm agresiv dhe shovinist të pushtuesve dhe të agresorëve të ndryshëm, duke përjetuar kështu ndarjen e kombit dhe pazarllëqet me trojet e tyre.

Ideografi, shqetësime që përkojnë

***“Se Zoti vetë e tha me gojë,
Se kombet shuhen përmbi dhé...”***

⁴ Anthony Smith, *Kombet dhe Nacionalizmi në erën globale*, Dudaj, Tiranë, 1995, f. 174.

⁵ Robert H. Wiebe, *Who We Are: A History of Popular Nationalism*, Princeton: Princeton University Press, 2002, f. XII.

Janë këto vargjet e himnit tonë kombëtar, kompozimit patriotik që ngjall emocione dhe lavdëron historinë, traditën dhe betejat e popullit tonë për liri dhe pavarësi. Sa herë që flitet për kombin tonë, padrejtësisht të ndarë e të trandur, vargjet e himnit kombëtar duket se ngërthejnë rrëfimin për ne ndër shekuj, gjerë e gjatë në Gadishullin Ballkanik, të cilin ndoshta do të kishte qenë më mirë ta quanim Gadishulli Vullkanik, sepse edhe sot ai i ngjason një vullkani që rrezikon të shpërthejë.

Me këtë shkrim do të doja të paraqes një reflektim krahasues nga këndvështrimi i lexuesit, të nxitur e të frymëzuar nga dy vepra të njohura ndër ne, atë të profesor Masar Stavileci me titull *Apologji e çështjes shqiptare*⁶ dhe veprën e Ismail Kadaresë, *Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, provë letrare*⁷. Të dy këto vepra trazojnë ndjenjën për gjithëkombëtaren tonë, krijojnë gjatë leximit ndjenjën e simbiozës midis tyre, nxisin përjetimin e historisë sonë kombëtare dhe kureshtjen e lexuesit për çështjen shqiptare në rrethana të caktuara historike dhe politike. Ajo që është më e rëndësishmja, të dyja këto vepra të shkruara nga autorë të ndryshëm dhe në rrethana plotësisht të ndryshme politike për kombin, ngrenë shqetësime të njëjta: përparimin e kombit, bashkimin e tij, për të mirën e përgjithshme të të gjithëve. Të dy autorët në këto vepra reflektojnë pa ndalur përpjekjet, ngritjet, rëniet, shkëlqimin dhe venitjen, të bardhën dhe të zezën.

Shqiptarët gjatë historisë së tyre u ballafaquan gjithmonë me pengesa nga më të ndryshmet. Si popull autokton në Ballkan, shqiptarët nuk i gëzuan privilegjet që i patën popujt e tjerë, apo thënë më mirë, fqinjët e tyre ballkanikë. Feja e sjellë nga otomanët që pushtuan trojet etnike, i ndau shqiptarët në myslimanë si shumicë me ca privilegja, por jo edhe lehtësime në fushën e arsimit në gjuhën amtare; për dallim nga të krishterët të cilët nuk patën privilegje të ofruara nga pushtuesi, por nuk patën as ndalesa të theksuara arsimore. Duket se ndikoi edhe relievi; pjesa veriore, mbeti e

⁶ M. Stavileci, Vep.cit.

⁷ I. Kadare, Vep. cit.

prapambetur, e pazhvilluar edhe ekonomikisht, dhe ajo jugore e cila gëzoi të drejtën për t'u zhvilluar dhe e cila "kishte arritur një shoqëri më shumë të përparuar, ndonëse ende patriakale"⁸. Dallimet e tilla ekonomike, fetare dhe edukative ndikuan mjaft, por jo përgjithmonë, në përçarjen e shqiptarëve. Përgjithësisht, shqiptarët patën shumë pak mundësi arsimimi, sepse kjo i pengonte të dy fuqitë e mëdha botërore, meqë të arsimuar, shqiptarët do të kishin mundësi më shumë "të kuptonin individualitetin e tyre kombëtar"⁹.

Në fund të shekullit XIX, duke parë shembjen e Perandorisë Otomane, rilindësit filluan të projektonin të ardhmen e Shqipërisë - shtet. "Ne të gjithë kemi fe Perëndinë dhe nënë e atë Shqipërinë . Kushdo le t'i falet Perëndisë si të dojë. Po kjo nuk bën të na ndanjë ", kishte thënë Naim Frashëri në librin e tij "*Liga e vërtetë e Shqiptarëve*"¹⁰.

Profesor Stavileci në veprën e tij e paraqet popullin shqiptar si "...populli më evropian i Ballkanit...popull i cili asnjëherë nuk ishte shkaktor i luftërave, i grindjeve, i sulmeve apo i okupimit të trojeve të tjerëve"¹¹, por njëkohësisht edhe si popull "...i cili nuk ngurroi të merrte pjesë në luftërat çlirimtare, sidomos në luftërat antiotomane gjatë shekujve XV-XVII"¹², i paraqet "...lidhjet e shqiptarëve me popuj të ndryshëm në Evropë, të përhershme..."¹³ dhe shekullin XIX-të si "shekulli i prapaskenave antishqiptare dhe i planeve rreth amputimeve serioze të viseve etnike shqiptare"¹⁴.

Përse ne, shqiptarët, toleruam të na ndodhte një gjë e tillë gjatë historisë tonë aq të lashtë? Përse ne shqiptarët lejuam të ndodhte "aneksimi i Çamërisë nga Greqia me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913"¹⁵ duke bërë kështu të mundshëm dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre stërgjyshore ose helenizimin e

⁸ Stavro S. Skendi, *Zgjidhje Kombëtar Shqiptar*, Phoenix, Tiranë, 2000, f. 419.

⁹ Po aty, f. 420.

¹⁰ Po aty, f. 159.

¹¹ M. Stavileci, vep. cit. f. 21, 24, 25.

¹² Po aty, f. 22.

¹³ Po aty, f. 21.

¹⁴ Po aty, f. 23.

¹⁵ Po aty, f.44.

tyre; apo përse lejuam që as “në Kongresin e Berlinit të mos njihemi si komb”?¹⁶ Siç duket, “mungesa e ngritjes së çështjes së pazgjidhur kombëtare në tërësinë e saj nga ana e subjekteve tona politike mbarëkombëtare, si dhe mungesa e bashkërenditjes së veprimeve dhe të qëndrimeve të përbashkëta, shihen këtu si ana jonë e dobët”, thekson profesor M. Stavileci¹⁷, sepse edhe pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, shqiptarët qenë të detyruar të luftojnë për të penguar shpërbërjen e shtetit të tyre edhe ashtu të copëtuar, meqë fati i vendit të tyre ishte përsëri në duart e Fuqive të Mëdha. Njohja e pavarësisë së Shqipërisë në kufijtë e saj të sotëm e dëmtoi kombin shqiptar, sepse “jashtë kufijve të saj mbet mbi gjysma e trojeve dhe e kombit shqiptar nën sundimin serb, malazias e grek”¹⁸. “Të copëtuar nën sovranitetin e sllavëve të Jugut”, shkruan profesor Stavileci, shqiptarët do të përjetonin “çintegrimin e tyre më të madh të entitetit të tyre historik, politik, ekonomik, kulturor e gjuhësor” dhe do të pengoheshin për “bashkimin e tyre me gjysmën tjetër të kombit shqiptar”¹⁹.

Si më të vjetrit në Ballkan dhe në Evropë, më të numërt se të tjerët, gjithmonë kundër pushtimeve dhe pushtuesve, me “emra të njohur protoshqiptarë e shqiptarë që nga antika e deri në ditët e sotme, si Diokliciani, Jan Kukuzeli, Barleti, Biçikemi, papët e Vatikanit, Leonik Tomeu, rilindësit tanë nga Hoxhë Hasan Tahsini, Pashko Vasa e Sami Frashëri, deri te bashkëkohësit tanë të gjallë”, shkruan profesor Stavileci²⁰, dhe pastaj me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, kur, siç shkruan Ismail Kadare, “...flamuri dhe himni u bashkuan, më në fund në Vlorë ... për të qenë të pranishëm, herë së bashku e herë veçmas, në ritet e shtetit shqiptar”²¹, prapëseprapë toleruam që projekti famëkeq *Naçertanija* e Ilija Garashaninit të mbetet gjallë edhe pse shteti shqiptar ishte krijuar.

¹⁶ Po aty, f. 44.

¹⁷ Po aty, f. 8.

¹⁸ Po aty, f. 50.

¹⁹ Po aty, f. 49.

²⁰ Po aty, f. 25.

²¹ I. Kadare, vep. cit. f.11.

Garashanini e vazhdoi avazin e Vasa Çubrilloviqit, me projektin famëkeq "Istjerivanje arnauta"²² dhe shpërbërjen e Shqipërisë "as më dysh, as më katërsh, as më tetësh, por fund e krye duhej shpërbërë; me të gjitha mjetet: ushtri, polici, terror, armë, qen, përdhunim grash, reformë agrare", shkruan Ismail Kadare²³; fryma e Garashanit do ta eklipsojë edhe nobelistin Ivo Andriq me "Elaborat"-in e tij, po ashtu famëkeq, dhe "propozimet e tij që kanë të bëjnë me çështjen shqiptare në kontekstin ballkanik dhe atë evropian, që në atë kohë lidhej ngushtë me daljen e Serbisë në Adriatik", thekson profesor Masar Stavileci²⁴, ku nënvizoi me ngulm që:

"Me ndarjen e Shqipërisë do të zhdukej qendra tërheqëse për pakicën shqiptare të Kosovës, e cila, në situatën e re, do të asimilohej më lehtë. Ne do të përfitonim edhe nja 2-3 qind mijë shqiptarë, por shumica e tyre janë katolikë, marrëdhëniet e të cilëve me shqiptarë myslimanë kurrë nuk kanë qenë të mira. Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë për në Turqi do të realizohej gjithashtu në rrethana të reja, sepse nuk do të ekzistonte ndonjë aksion i fortë për ta penguar atë".²⁵

Më tutje, në veprat e të dy autorëve mund të vërehet një përshkrim i jashtëzakonshëm i zhvillimeve të mëtejme politike dhe historike, përshkrimi i rindezjes së ndjenjës shkatërrimtare dhe energjisë negative të serbët, që kurrë nuk kishte fjetur, të cilët "ilircitetin e shqiptarëve e ndërmendonin të rrezikshëm për idilin jugosllav"²⁶ dhe të cilët shembjen e Jugosllavisë komuniste e filluan "më parë me fushatën kundërshqiptare sesa me argumentin antikomunist", thotë në veprën e tij profesor M. Stavileci²⁷.

Cinizmi dhe ironia më e madhe e tërë kësaj politike antishqiptare është se serbët kërkojnë bashkimin e të gjithë serbëve kudo që janë në një shtet të vetëm, qofshin ata edhe të vdekur, ndërsa rrënojnë çdo gjë që nuk është serbe, duke e paraqitur veten gjithnjë si popull i vuajtur e i përbuzur nga të tjerët, por i zgjedhur nga vetë Zoti (i vetëquajturi

²² "Dëbimi i arnautëve" - i shqiptarëve. V.LI.

²³ I. Kadare, vep.cit. f. 27.

²⁴ M. Stavileci, vep. cit. f. 109.

²⁵ Po aty, f. 122.

²⁶ I. Kadare, Vep. Cit. f. 118-119..

²⁷ M. Stavileci, Vep. cit. f. 148.

"popull hyjnor", në origjinal "nebeski narod"). Megjithatë, urrejtjen ndaj shqiptarëve, serbët as që përpiqen ta fshehin apo ta minimizojnë.

Ismail Kadare kujton Miroslav Kërlezhën e viteve '30 të shekullit të kaluar për të parë mënyrën se si serbët në Beograd i kishin përshkruar shqiptarët: "... si raja të paemër, të një vendi të paemër, pa histori, pa letërsi dhe pa gjuhë letrare, pa tradita, pa poezi, pra, pa të gjitha ato përcaktime që njeriun e bëjnë njeri dhe fisin e bëjnë fis njerëzor..."²⁸.

Kundër një paragjykimi të tillë nënçmues, me të drejtë profesor M. Stavileci, në veprën e tij flet "për krijimin e Kuvendit Mbarëkombëtar si akt i pjekurisë historike e që do të kishte si objektiv themelor pajtimin dhe bashkimin kombëtar shqiptar"²⁹; një Kuvend i cili do t'i bashkonte të gjithë shqiptarët pa dallim, "pa mëri e hasmëri kolektive e individuale, duke ruajtur kësisoji vlerat më të larta njerëzore"³⁰.

"Ferri nuk janë vetëm të tjerët"

Shqipëria është një shtet 100 vjeçar; Kosova sapo e shpalli pavarësinë e saj, katër vjet më parë. Edhe pse jemi dy pjesë të ndara të një tërësie etnike, jemi popull që, siç theksohet në veprën e cituar të profesor Stavileci "synojmë të ndërtojmë një shoqëri civile e demokratike."

Thënien e famshme të Sartrit, në dramën "Me dyer të mbyllura": "Ferri janë të tjerët", profesor Stavileci e ka adoptuar dhe vënë moto të librit të tij, duke e zgjeruar, në rastin tonë, se "Ferri nuk janë vetëm të tjerët"; i bëjmë, pra, gabimet për fat të keq vazhdimisht, duke harruar edhe thënien e Ernest Renan-it të vitit 1882, të cilën e citon Kadare, se "kombi është një shpirt, një parim shpirtëror"³¹. Historia, siç shkruan Prof. Stavileci, "dënon vetvetiu çdo popull që nuk është në gjendje të nxjerrë mësimin e duhur, sidomos nga përvoja e vet e hidhur historike; ajo dënon çdo popull që lejon të ndodhë historia, me gjithë mundësinë relative të njerërisë së saj, pa të ose kundër tij!"³².

²⁸ I. Kadare, Vep. cit. f. 122.

²⁹ M. Stavileci, Vep. cit. f.11.

³⁰ Po aty, f. 14.

³¹ I. Kadare, Vep. cit. f. 167.

³² M. Stavileci, Vep. cit. f. 168.

Dhe nëse sipas vargjeve të himnit kombëtar: "Zoti e ka thënë me gojë, se kombet shuhen përmbi dhé..." a mos vallë do të lejojmë të shuhemi si komb, sepse po harrojmë Pashko Vasën që "shqiptarizmi është ideologji e vetme, e shenjtë e shqiptarit" siç thotë edhe profesor M. Stavileci, duke parafrazuar këtë të fundit³³, apo "për të do të luftojmë NE, që të rrojmë", duke përmbushur kështu ëndrrën e rilindësve shqiptarë, "misionarëve të shpresës" siç i quan Ismail Kadare, duke ndërtuar dhe forcuar shoqërinë tonë demokratike dhe të civilizuar, sepse "fati i shqiptarëve është në duart e vetë shqiptarëve"³⁴.

Përfundim

Dhe kështu, duke vlerësuar objektivisht të dy veprat, herë njëherë e herë tjetrën, mund të kënaqemi me lidhjen e tyre të ngushtë që kanë vetvetiu ato, për të rikujtuar dallgët në të cilat është përplasur kombi ynë ndër shekuj, por edhe shqetësimet e rendjes së politikës pas interesave të ngushta dhe mosgatishmëria e tejkalimeve të interesave meskine në shërbimin e atyre madhore kombëtare.

Sot, Evropa është përpara shqiptarëve -"shtëpia jonë e rigjetur" siç e quan Kadare atë. Por, gjithnjë duke u integruar në vlerat e përbashkëta evropiane, qoftë dhe me dy njësi shtetërore, ne shqiptarët nuk duhet harruar thënien e njohur të ish- kryeministrit anglez, Tony Blair, që kombet "duhet ta ruajnë identitetin e tyre kombëtar".

Bibliografia:

Anderson, Benedict. *Imagined Communities* (Revised Edition)..London: Verso,2006.

Gellner, Ernest. *Nationalism*. Great Britain: Weidenfeld & Nicholson, 1997.

Glenny, Misha. *The Balkans: Nationalism, War, and the Great Powers, 1804-1999*. New York, New York: Penguin Books,2001.

³³ Po aty, f. 15.

³⁴ I. Kadare, f.205.

- Guibernau, Montserrat. & Hutchinson, John. *Understanding Nationalism*. Cambridge: Polity Press,(2001).
- Hutchinson,John & Smith, Anthony, *Nationalism:The Reader*, Oxford: Oxford University Press,1994.
- Kadare, Ismail. *Mosmarrëveshja: Mbi raportet e Shqipërisë me vetveten,provë letrare*. Tiranë: Onufri,2010.
- Kaplan, D.Robert. *Balkan Ghosts: A Journey Through History*. New York: Picador St. Martin's Press,1993.
- Skendi,S. Stavro. *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*. Tiranë: Phoenix,2000.
- Smith, D. Anthony. *Kombet dhe Nacionalizmi në Erën Globale*. Tiranë:Dudaj,1995.
- Stavileci, Masar. *Apologji e çështjes shqiptare*. Prishtinë:Forumi I Intelektualëve Shqiptarë (FISH),1998. (Reprografuar më 2009).
- Wiebe, H.Robert. *Who We Are: A History of Popular Nationalism*. Princeton: Princeton University Press, 2002.